



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
ëëë.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Fjalimi i Prof. Asoc. Dr. Artan Dërmaku me rastin e pranimit të detyrës së Rektorit të Universitetit Publik „Kadri Zeka“

I nderuar Rektor Kosumi,

I nderuar Kryetar i Këshillit Drejtues të Universitetit, prof. Ilir Gjinolli si dhe anëtarë të tjerë të Këshillit Drejtues,

I nderuar Kryetar i Komunës së Kamenicës z. Kadri Rahimaj

E nderuara Nënkyetare e Komunës së Gjilanit znj. Leonora Bunjaku-Morina

Të nderuar deputetë, **kryeprokuror, kryetar i gjykatës**, drejtorë institucionesh dhe pjesëtarë të shoqërisë civile, përfaqësues të Bizneseve,

Të nderuar profesorë, asistentë, staf administrativ dhe kolegë tjerë të Universitetit,

Të dashur familjarë që sot jeni prezent,

E në veçanti shumë të dashur e të respektuar studentë

Jam shumë i nderuar të jem sot para jush teksa pranoj postin e Rektorit në këtë Institucion të çmuar. Mirënjohja ime është e thellë për të gjithë anëtarët e këshillit drejtues, profesorët, studentët, stafin administrativ dhe të gjithë juve të tjerëve që keni besuar tek unë për ta udhëhequr këtë universitet në një epokë të re dhe shumë premtuese për ne. Për mua është një entuziazëm i jashtëzakonshëm dhe një ndjenjë e thellë përgjegjësie që të hyj në këtë sfidë si Rektori juaj i Ri, për të përmbushur këtë detyrë të madhe për t'i shërbyer komunitetit tonë akademik dhe për të kontribuar në ndërtimin e vizionit të arsimit të lartë në shekullin e 21-të. Jam plotësisht i motivuar dhe i përgjegjshëm për sfidën që kemi përpara, dhe ndjej një entuziazëm të madh për të formësuar të ardhmen së këtij universiteti dhe të studentëve tanë të dashur.

Universiteti Publik "Kadri Zeka", që nga themelimi i tij, ka krijuar një trashëgimi të çmuar në angazhimin e tij si Institucion për krijimin e përsosmërisë në arsim. Ky institucion veçse është etabluar si një gjenerator dijeje dhe inovacioni, duke prodhuar udhëheqës, studiues dhe vizionarë që kanë lënë gjurmë në shoqërinë tonë kosovare dhe më tutje. Është zotimi im solemn për të mbështetur dhe fuqizuar edhe më shumë vlerat dhe traditat që ka ky Institucion duke i përshtatur me sfidat gjithnjë e më shumë në rritje që po paraqiten si pasojë e globalizimit, migrimit, dhe ndryshimeve të mëdha në filozofinë e përgatitjes profesionale.

Bota dhe shoqëritë po evoluojnë me një ritëm të shpejte dhe arsimit të lartë po ndryshon në

mënyre substanciale. Teknologjia dhe Digjitalizimi po krijojnë një botëkuptim të ri të zhvillimit shoqëror dhe kur kësaj ti shtojmë faktin që veçse kemi hyrë në një shoqëri globale dinamike dhe të ndërlidhur, është detyra e jona si Universitet që studentët tanë t'i pajisim jo vetëm me njohuri, por edhe me aftësitë, vlerat dhe qëndrueshmërinë që atyre u nevojitet për t'u zhvilluar, të jenë konkurrent dhe pse jo për të bërë ndikime edhe me pozitive në shoqëri.

Ne vazhdim unë do të doja të ndaja me ju parimet kyçe që do t'i ndjek gjatë punës time si Rektor:

1. Inovacioni dhe Përshtatshmëria: Ne duhet të pranojmë sfidën që të zhvillojmë inovacionin në çdo aspekt të funksionimit të universitetit tonë. Modelet tradicionale të edukimit po evoluojnë dhe ne duhet të evoluojmë bashkë me to. Kjo nënkupton adoptimin e metodave inovative të mësimdhënies, integrimin e teknologjisë më të fundit në ligjëratat tona dhe nxitjen e një kulture të përmirësimit të vazhdueshëm. Ne duhet të jemi të shkathët dhe të hapur ndaj ndryshimeve për të përmbushur nevojat gjithnjë në zhvillim të studentëve dhe shoqërisë.

2. Profilizimi: Në Kosovë, ka një numër të madh të Institucioneve të arsimit të lartë, si ato publike ashtu edhe private. Pothuajse në të gjitha këto Institucione po replikohen programe të njëjta apo të ngjashme, pa marr parasysh nëse ekzistenca e këtyre programeve do të jetë e nevojshme për shoqërinë tonë në një të ardhme të afërt. Edhe Ministria e Arsimit, por edhe eksperte të ndryshëm po propozojnë strategji për dalje nga situata ku sipas të gjitha gjasave do të jetë e nevojshme profilizimi i Institucioneve. Por, le të përcaktojmë fillimisht se çfarë do të thotë "profilizimi" ose "profesionalizimi" i një universiteti. Në thelb, kjo ka të bëjë me idenë e përshtatjes së programeve akademike dhe ofertave tona për të përputhur më ngushtë me nevojat dhe pritjet e tregut të punës dhe shoqërisë në përgjithësi. Përfshin identifikimin e fushave kyçe të specializimit, ku universiteti ynë mund të shquhet, dhe pastaj fokusimin e burimeve, hulumtimit dhe zhvillimit të kurrikulave në ato fusha. Unë si Rektor, do ti orientoj të gjitha njohuritë që posedoj që së bashku me stafin e Universitetit të arrijmë të pozicionohemi në mënyrën më të mirë në këtë sfidë të profilizimit. Kështu ne do të jemi në gjendje të përgjigjemi fuqishëm Kërkesave të Tregut të Punës që po ndryshojnë, përmirësimi i relevancës dhe mundësive të punësimit për Studentë, krijimin dhe mbajtjen e talenteve brenda Universitetit, Ekselencë në Hulumtim, Ndikimi Ekonomik në komunitet etj.

Prandaj me siguri të madhe ju them se profilizimi i universitetit tonë nuk është vetëm një zgjedhje, por një nevojë para sfidave të shpejta që po ndodhin në shtetin tonë. Duke pranuar profilizimin, ne mund të shtojmë cilësinë dhe relevancën në arsimin tonë, do t'i fuqizojmë studentët tanë për sukses, dhe do të pozicionojmë universitetin tonë si një Institucion të respektuar në Kosovë dhe më gjerë.

3. Angazhimi global: Në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur, studentët tanë duhet të përgatiten të angazhohen në skenën globale. Ne do të zgjerojmë mundësitë për programe shkëmbimi ndërkombëtar, studime të përbashkëta, bashkëpunime kërkimore dhe përvoja globale për t'i pajisur studentët tanë me perspektivat globale dhe kompetencat ndërkulturore thelbësore për suksesin në shekullin e 21-të.

4. Angazhimi ne Komunitetit: Ne nuk jemi dhe nuk do të duhej të shihemi si një institucion i izoluar; por të shihemi si një pjesë integrale e komunitetit të gjerë. Ne do të thellojmë partneritetet tona me organizatat dhe bizneset lokale, duke shfrytëzuar njohuritë dhe burimet tona kolektive për të adresuar sfidat urgjente të komunitetit tonë. Në këtë mënyrë Studentët tanë do të fitojnë përvoja të çmueshme përderisa Institucioni ynë do të kontribuojë pozitivisht në shoqërinë që na rrethon.

5. Arsimi me qendër studentin: Studentët tanë janë arsyeja e ekzistencës së Institucionit tonë dhe suksesi i tyre është sukses i joni dhe njëherit shqetësimi ynë kryesor. Ne do t'u ofrojmë atyre mbështetje, burime dhe mundësi të palëkundura për të krijuar të ardhme të shkëlqyer akademike, personale dhe profesionale. Studentët në Universitetin Publik "Kadri Zeka" nuk do të jenë vetëm ata studentët të cilët dëgjojnë se çka u shpjegohet, por do të jenë partnerët tanë kryesor në hulumtime, zhvillime, pjesë integrale e kurrikulave dhe akterët kryesor në vendimmarrje.

6. Ekselencia e Kërkimit: Ky universitet do të bëhet një Institucion i cili do të jetë krenar me hulumtimet që stafi i tij do t'i realizoj. Ky Universitet do të jetë në vazhdimësi në kërkime dhe hulumtime shkencore. Fakultetet, stafi dhe studentët tanë do të vazhdojnë të nxisin inovacionin dhe hulumtimin dhe do të kenë përkrahje të pa rezervë të menaxhmentit. Se bashku me Këshillin Drejtues do të realizojmë mundësinë që punimet shkencore të stafit tonë mbulohen financiarisht nga Universiteti, që Institutet tona brenda Universitetit të zhvillohen dhe me hulumtimet e tyre të ndihmojnë komunitetin.

Të nderuar pjesëmarrës. Sot jam i mbushur me emocione dhe optimizëm ndërsa po e nis këtë rrugëtim si Rektori juaj i ri. Së bashku, ne do të formojmë të ardhmen e këtij institucioni dhe do t'i fuqizojmë studentët tanë që të bëhen liderët, novatorët dhe ndryshuesit e së nesërme. Kuptohet se për të arritur këto nevojiten punë dhe angazhime të gjithanshme për tu bërë, por edhe mjete të shumta financiare. Dhe shumë e rëndësishme për t'u cekur, nevojitet kampus i ri i të cilin ende nuk e ka realizuar Universiteti. Së bashku me Këshillin Drejtues, Komunën e Gjilanit dhe akteret tjerë të Ministrisë, do të punojmë përsëritur që të realizojmë kampusin e ri, me të gjitha sallat, amfiteatrit mësimore, laboratorët e ndryshme etj, të cilat janë me se të nevojshme që të zhvillohemi si Institucion i respektuar.

Për fund, falënderoj secilin prej jush për besimin që më keni dhënë dhe për përkushtimin tuaj për të ardhmen e ndritur të institucionit tonë. Së bashku, ne do të arrijmë madhështinë dhe do të frymëzojmë brezat që do të vijnë. Faleminderit.

Gjilan, 2.10.2023